

VENDIM
Nr. 520, datë 30.6.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 436, DATË 3.6.2020, “PËR
PËRCAKTIMIN E KRITERIT TË NOTËS MESATARE
PËR PRANIMIN E KANDIDATËVE NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË
CIKLIT TË PARË DHE NË PROGRAMET E INTEGRUARA
TË STUDIMEVE TË CIKLIT TË DYTË OSE TRANSFERIMIN
E STUDIMEVE NË VITET E NDËRMJETME
TË KËTYRE PROGRAMEVE, NË INSTITUCIONET E ARSIMIT
TË LARTË, PËR VITET AKADEMIKE 2020–2021 DHE 2021–2022 E NË VIJIM”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 74, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 436, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Titulli i vendimit ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë”.

b) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Kandidatët, për t’u pranuar në programet e studimit të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, duhet të kenë përfunduar me sukses arsimin e mesëm të lartë, minimalisht me notë mesatare 6.5 (gjashtë pikë pesë). Për pranimin në programet e studimit të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, nota mesatare të jetë minimalisht:

a) 7 (shtatë) për pranimin në programet e studimit të ciklit të parë në fushën e mësuesisë për gjuhët e huaja;

b) 7.5 (shtatë pikë pesë) për pranimin në programet e studimit të ciklit të parë, të cilat japin akses në programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë;

c) 7.5 (shtatë pikë pesë) për pranimin në programin e studimit të ciklit të parë, që përgatit mësues për arsimin parashkollor, program, i cili nuk jep akses në programet e ciklit të dytë në fushën e mësuesisë për arsimin fillor, arsimin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë.”.

c) Në pikën 3/1, fjalët “... të përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1, të vendimit ...” zëvendësohen me “... të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të vendimit ...”;

ç) Shtojcat nr. 1 dhe nr. 2 zëvendësohen me shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit, institucioni përgjegjës për ofrimin e shërbimeve arsimore, institucionet e arsimit të mesëm të lartë, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1

Nr.	Institucionet e arsimit të lartë	Programet e studimit “Bachelor” për gjuhët e huaja	Nota mesatare 7	Programet e studimit “Bachelor”, që japin akses në programet e ciklit të dytë master në fushën e mësuesisë	Nota mesatare 7.5	Programet e studimit “Bachelor” për arsimin parashkollor, që nuk japin akses në programet e ciklit të dytë master për arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë	Nota mesatare 7.5
1	Universiteti i Tiranës	Gjuhë angleze	7	Gjuhë-letërsi	7.5		-
		Gjuhë frënge		Biologji			
		Gjuhë, letërsi dhe qytetërim gjermanishtfolës		Kimi			
		Italianistikë, profili gjuhë, letërsi dhe qytetërim italian		Matematikë			
		Gjuhë turke		Fizikë			
		Gjuhë greke		Informatikë			
		Gjuhë spanjolle me profil gjuhë-letërsi dhe qytetërim hispanik		Gjeografi			
		Gjuhë frënge dhe gjuhë e shenjave shqip		Histori			
				Filozofi			
2	Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës	Gjuhë angleze	7	Gjuhë-letërsi	7.5	Mësuesi për arsim parashkollor	7.5
		Gjuhë gjermane dhe angleze		Matematikë-informatikë			
				Mësuesi për arsim fillor			
				Psikologji			
				Filozofi-sociologji			
3	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”	Gjuhë angleze	7	Biologji-kimi	7.5	Mësuesi për arsim parashkollor	7.5
		Gjuhë frënge		Histori-gjeografi			
		Gjuhë gjermane		Gjuhë shqipe dhe letërsi			
				Matematikë informatike			
				Matematikë-fizikë			
				Mësuesi për arsim fillor			
		Gjuhë italiane		Psikologji			

				Filozofi-sociologji			
4	Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër	Gjuhë angleze	7	Biologji-kimi	7.5	Mësuesi për arsim parashkollor	7.5
		Gjuhë frënge		Fizikë			
		Gjuhë gjermane		Gjeografi			
		Gjuhë italiane		Gjuhë-letërsi			
				Histori			
				Informatikë			
				Matematikë			
				Mësuesi për arsim fillor			
				Psikologji			
				Pedagogji muzikore			
5	Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë	Gjuhë angleze	7	Biologji	7.5	Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
				Kimi			
				Matematikë			
				Matematikë-fizikë			
				Matematikë-informatikë			
				Informatikë			
		Gjuhë italiane		Gjuhë shqipe dhe letërsi			
				Histori-gjeografi			
				Mësuesi për arsimin fillor			
				Pedagogji e specializuar			
6	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë	Gjuhë angleze	7	Matematikë-fizikë	7.5	Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
				Biologji-kimi			
		Gjuhë dhe kulturë frënge		Histori-gjeografi			
				Gjuhë-letërsi			
				Mësuesi për arsim fillor			
7	Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë	Gjuhë angleze	7	Biologji-kimi	7.5	Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
				Gjuhë-letërsi shqipe			
				Gjuhë-letërsi dhe qytetërim grek			
				Histori-gjeografi			
				Matematikë-informatikë			
				Mësuesi për arsimin fillor			
8	Universiteti “Albanian University”	Gjuhë angleze	7	Mësuesi për arsimin fillor	7.5	Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
				Psikologji e përgjithshme			

9	Kolegji Universitar “Logos”	Gjuhë dhe civilizim grek	7			Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5
10	Kolegji Universitar “Bedër”	Gjuhë dhe letërsi angleze	7				
11	Universiteti “Barleti”			Psikologji	7.5		
12	Universiteti Evropian i Tiranës			Psikologji	7.5		7.5
13	Universiteti “New York i Tiranës”			Psikologji Gjuhë dhe letërsi turke	7.5		7.5
14	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë			Mësuesi për arsimin fillor Psikologji e përgjithshme	7.5	Mësuesi për arsimin parashkollor	7.5